

HEART

HEART: Shërim dhe Edukim nëpërmjet Arteve

PËRSHTATJET PËR AKTIVITETET E HEART

Ju duhet te mendoni për përshtatjet e aktiviteteve të HEART ashtu që të gjithë fëmijët të mund të përfitojnë nga këto aktivitete. Duke njohur fëmijën me të cilin/en jeni duke zhvilluar aktivitetet e HEART është tejet e rëndësishme ashtu siç është njohuria juaj për të akomoduar këto aktivitete. Jepuni fëmijëve kohë të mjaftueshme.

SUGJERIME PËR PËRSHTATJEN E AKTIVITETEVE HEART PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA, SIPAS NEVOJAVE TË TYRE

Në seksionin në vijim ju ofrojmë disa udhëzime për përshtatjen e aktiviteteve bazuar në llojet e ndryshme të vështirësive me të cilat mund të ballafaqohen disa fëmijë.

1. Vështirësi fizike ose motorike
2. Vështirësi në shikim
3. Vështirësi në të dëgjuar
4. Vështirësi në të nxënë dhe të kuptuar
5. Vështirësi për të qëndruar i/e përqëndruar dhe për t'u sjellur mirë
6. Hiperaktiv apo hiposensitiv
7. Vështirësi në komunikim



SHËNIM:

Disa fëmijë mund të kenë aftësi të kufizuara të shumëfishta dhe rrjedhimisht mund të përfitojnë nga përshtatjet e listuara nën më shumë se njëra nga kategoritë më poshtë.

I. PËRSHTATJET PËR FËMIJËT QË KANË VËSHTIRËSI FIZIKE

Ka shumë lloje të ndryshme vështirësish fizike që mund të ndikojnë në aftësinë e fëmijës për të kryer aktivitetet HEART. Disa fëmijë mund të kenë vështirësi me aftësitë motorike të mëdha (si lëvizja e krahëve, këmbëve ose trupit), ndërsa të tjerë mund të kenë vështirësi me aftësitë motorike të vogla (si lëvizja e duarve dhe gishtave me saktësi). Merrni në konsideratë vështirësitë individuale që ka një fëmija me lëvizjen fizike, dhe përpiquni të përqendrohni në atë që ai/ajo mund të bëjë, dhe jo në atë që ai/ajo nuk mund të bëjë.

Vështirësitë fizike me të cilat mund të përballen fëmijët:

- Vështirësi në të ecur;
- Vështirësi për të lëvizur midis grupeve të fëmijëve, tavolinave etj;
- Vështirësi për të qëndruar në këmbë për periudha kohore të gjata;
- Vështirësi për kapjen e objekteve të vogla, si lapsa, stilolapsa, ose gërrshërë;

KONSIDERATAT SPECIFIKE GJATË PËRSHTATJES SË AKTIVITETEVE HEART PËR FËMIJËT ME VËSHTIRËSI FIZIKE MUND TË PËRFSHIJNË:

- ✓ Jini fleksibël se ku dhe si fëmija zgjedh të ulet dhe të punojë – para se të filloni aktivitetin HEART, sigurohuni se ai/ajo ndihet rehat;
- ✓ Gjatë aktiviteteve të lëvizjes së trupit, ofrojuni fëmijëve mënyra të ndryshme për pjesëmarrje.
- ✓ Sigurohuni se të gjithë fëmijët e kanë të lehtë të kenë qasje në material- vendosini afër tyre.
- ✓ Nëse ndonjë prej aktiviteteve kërkon prerjen e materialeve, sigurohuni që të keni në dispozicion materiale që janë prerë më parë;
- ✓ Nëse një fëmijë ka vështirësi për të mbajtur të palëvizshme fletën e tij/saj, ngjiteni atë në tavolinë ose këmbalec, në mënyrë që të mos lëvizë lehtësisht;
- ✓ Mbështeteni fëmijën që të përdorë një pjesë tjetër të trupit për të krijuar art (p.sh. mbajtja e lapustilës me bërryl ose me gishtat e këmbës);
- ✓ Lejojeni fëmijën që të bëjë pushime sipas nevojës;
- ✓ Nxitini të gjithë fëmijët të kërkojnë ndihmë nëse kanë nevojë.

SHËNIM:

Përzgjidhni vetëm rekomandimet që përshtaten me nevojat e fëmijëve tuaj; jo të gjitha rekomandimet do të jenë të përshtatshme në të gjitha situatat.

2. PËRSHTATJET PËR FËMIJËT QË KANË VËSHTIRËSI NË SHIKIM

Vështirësitë në shikim me të cilat mund të përballen fëmijët:

- Verbëri;
- Shikim i pakët;
- Vështirësi në dallimin e ngjyrave të ndryshme;
- Vështirësi për të parë mirë në distancë;
- Vështirësi për të dalluar objekte që janë afër.

KONSIDERATAT SPECIFIKE GJATË PËRSHTATJES SË AKTIVITETEVE HEART PËR FËMIJËT ME VËSHTIRËSI NË SHIKIM MUND TË PËRFSHIJNË

- ✓ Ju të siguroheni se fëmija ka qasje në materiale më të prekshme, si argjila, letër zmerile, shirita, letër faculete, etj.;
- ✓ Sigurohuni se dhoma ku po punoni është e ndriçuar mjaftueshëm
- ✓ Sigurohuni se materialet që do të përdoren për arte janë lehtësisht të arritshme nga fëmija, dhe orientojeni atë nëpërmjet çdo materiali që është në dispozicion, në mënyrë që ai/ajo të mund ta njohë atë vetëm duke e prekur dhe të gjejë vendndodhjen e tij
- ✓ Ndhimoheni fëmijën duke e orientuar dorën e tij/saj drejt letrës/vendit të punës kur ai/ajo fillon detyrën;
- ✓ Nëse shkruani udhëzime, sigurohuni që ato të shkruhen me shkronja të mëdha dhe të qarta, dhe që fjalët të lexohen gjithashtu me zë të lartë.

SHËNIM:

Përzgjidhni vetëm rekomandimet që përshtaten me nevojat e fëmijëve tuaj; jo të gjitha rekomandimet do të jenë të përshtatshme në të gjitha situatat.

3. PËRSHTATJET PËR FËMIJËT QË KANË VËSHTIRËSI NË DËGJIM

Vështirësitë në dëgjim me të cilat mund të përballen fëmijët:

- Shurdhim
- Vështirësi dëgjimi nga njëri vesh (i majtë ose i djathtë);
- Vështirësi dëgjimi nga të dy veshët;
- Paaftësi për të folur qartë ose pamundësi për të folur.

KONSIDERATAT SPECIFIKE GJATË PËRSHTATJES SË AKTIVITETEVE HEART PËR FËMIJËT ME VËSHTIRËSI NË DËGJIM MUND TË PËRFSHIJNË

- ✓ Flisni me zë të lartë dhe qartë kur përballeni me fëmijët;
- ✓ Sigurohuni se fëmija mund t'ju shohë fytyrën ndërkohë që flisni (për lexim më të thjeshtë të buzëve);
- ✓ Eliminoni zhurmën e panevojshme të mjedisit;
- ✓ Përdorni shenja ose gjeste kur flisni për të transmetuar më qartë atë që doni të thoni;
- ✓ Përdorni shprehjet e fytyrës për të ndihmuar në qartësimin e mendimit që përpiqeni të transmetoni;
- ✓ Demonstroni secilin aktivitet ndërkohë që e përshkruani atë, në mënyrë që fëmijët të jenë të ndërgjegjshëm për hapat që duhet të ndërmarrin;
- ✓ Nxiteni fëmijën të prezantojë punën e tij/saj duke përdorur fjalë kyçe ose nëpërmjet të shkruarit që mund të lexohet me zë të lartë;
- ✓ Verifikoni rregullisht me nxënësin nëse ai/ajo e kupton atë që thuhet;
- ✓ Përsëritni çfarë ka thënë fëmija për t'u siguruar se e keni kuptuar qartë;

SHËNIM:

Përzgjidhni vetëm rekomandimet që përshtaten me nevojat e fëmijëve tuaj; jo të gjitha rekomandimet do të jenë të përshtatshme në të gjitha situatat.

4. PËRSHTATJET PËR FËMIJËT QË KANË VËSHTIRËSI NË TË KUPTUARIT

Disa nga vështirësitë me të cilat përballen fëmijët që kanë vështirësi të të kuptuarit janë:

- Vështirësi në kuptimin e udhëzimeve;
- Kërkojnë më shumë kohë për të përpunuar informacionin;
- Harrojnë lehtësisht informacionin.

KONSIDERATAT SPECIFIKE GJATË PËRSHTATJES SË AKTIVITETEVE HEART PËR FËMIJËT ME VËSHTIRËSI TË TË KUPTUARIT

- ✓ Flisni ngadalë dhe qartë kur jepni udhëzimet;
- ✓ Prezantojeni informacionin në mënyrë vizuale dhe verbale;
- ✓ Ndajini udhëzimet në hapa të vegjël dhe përdorni fjalë konkrete;
- ✓ Jepini fëmijës kohë shtesë të përfundojë aktivitetet;
- ✓ Mos e ngutni fëmijën të përfundojë një detyrë;
- ✓ Kërkojini fëmijës udhëzimet pasi i keni dhënë ato;
- ✓ Dëgjoni me vëmendje
- ✓ Kur flisni përdorni sinjale vizuale, si piktura ose gjeste;
- ✓ Tregoni se çfarë jeni duke bërë ju ose fëmija ndërkohë që veproni;
- ✓ Bëjeni fëmijën të flasë për atë çka ai/ajo bën; bëni pyetje specifike;
- ✓ Nxitni përvojat praktike: prekjen, mbajtjen dhe eksplorimin;
- ✓ Si fillim pyesni nëse fëmija ka nevojë për ndihmë; mos hamendësoni se ndihma është e nevojshme dhe e dëshirueshme;
- ✓ Nxiteni fëmijën që t'ju informojë me një sinjal të veçantë nëse ai/ajo nuk kupton atë që thoni, tregoni, ose kërkonte të bëhet;
- ✓ Nëse fëmija nuk kupton atë që thoni, përpikuni ta riformuloni atë dhe jo ta përsëritni;

SHËNIM:

Përzgjidhni vetëm rekomandimet që përshatën me nevojat e fëmijëve tuaj; jo të gjitha rekomandimet do të jenë të përshatshme në të gjitha situatat.

5. PËRSHTATJET PËR FËMIJËT QË KANË VËSHTIRËSI ME PËRQENDRIMIN DHE SJELLJEN GJATË AKTIVITETIT

Disa nga sfidat me të cilat mund të përballen fëmijët me vështirësi në përqendrim janë:

- Shpërqendrim të lehtë;
- Vështirësi për t'iu përmbajtur një detyre;
- Vështirësi në përqendrim;
- Krijojnë pengesa për fëmijët e tjerë

KONSIDERATAT SPECIFIKE GJATË PËRSHTATJES SË AKTIVITETEVE HEART PËR FËMIJËT ME VËSHTIRËSI ME PËRQENDRIMIN DHE SJELLJEN

- ✓ Uleni fëmijën larg nga shpërqendrimet/zhurmat;
- ✓ Gjithmonë kur flisni me fëmijën thoni emrin e tij/saj;
- ✓ Planifikoni aktivitete që bazohen te interesat e fëmijës;
- ✓ Ndajini aktivitetet e ndërlikuara në pjesë më të vogla dhe të shkurtra;
- ✓ Nëse fëmija e ka të vështirë të qëndrojë ulur, atëherë përfshini edhe lëvizjen në aktivitet;
- ✓ Përforconi dhe shpërbleni sjelljen pozitive;
- ✓ Qëndroni ose uluni pranë fëmijës në mënyrë që ta ndihmoni nëse ka nevojë;
- ✓ Lejoni fëmijës të bëjë pushim kur ai/ajo ka nevojë;
- ✓ Përdorni elemente gjallërues kur ka pak energji/përqendrim;
- ✓ Jepini fëmijës një listë kontrolli ose plan me secilin nga hapat e aktivitetit;
- ✓ Sigurohuni që fëmiju/fëmijët të jenë të vëmendshëm para se të jepni udhëzime;
- ✓ Jepini mundësi çdo fëmije për të folur;
- ✓ Jepini fëmijës zgjidhje të arsyeshme;
- ✓ Identifikoni se çfarë përpiqet të fitojë apo shmangë fëmija që ka sjellje të papëlqyeshme, dhe nxitni një sjellje zëvendësuese të pranueshme që arrin rezultate për fëmijën;
- ✓ Nëse mundeni shmangni sjelljen negative;

SHËNIM:

Përzgjidhni vetëm rekomandimet që përshtaten me nevojat e fëmijëve tuaj; jo të gjitha rekomandimet do të jenë të përshtatshme në të gjitha situatat.

6. PËRSHTATJET PËR FËMIJËT QË JANË HIPERAKTIV OSE HIPOAKTIV

Disa nga vështirësitë me të cilat përballen fëmijët që kanë vështirësi me hiperaktivitet apo hipoaktivitet mund të jenë:

- Frustrohet jashtë mase kur klasa është shumë e zhurmshme ose e mbingarkuar;
- Frustrohet jashtë mase kur e prekin;
- Frustrohet kur ndryshon plani papritmas

KONSIDERATAT SPECIFIKE GJATË PËRSHTATJES SË AKTIVITETEVE HEART PËR FËMIJËT QË MBINXITEN LEHTËSISHT, MUND TË PËRFSHIJNË:

- ✓ Shmangni ndryshimin e menjëhershëm të aktiviteteve; lejoni kohë për përshtatje;
- ✓ Shpjegoni programin për ditën e fillimit të mësimin, dhe tregoni qartë nëse ose kur do të ndryshojë diçka,
- ✓ Jepini fëmijës më pak opsione materiale (për sa i përket ngjyrës dhe llojit);
- ✓ Jini një dëgjues i mire dhe vini re se si fëmiju po reagon gjatë sesioneve;
- ✓ Tregoni se çfarë jeni duke bërë ju ose fëmija ndërkohë që veproni;
- ✓ Shtoni ose pakësoni ndriçimin e dhomës për të shmangur shkëlqimin e tepërt;
- ✓ Shmangni qëndrimin me shpinë nga dritarja që mund të shkaktojë hije;
- ✓ Krijoni rutina dhe struktura për fëmijën;
- ✓ Përdorni mjete si kohëmatës, drita ose zile për të sinjalizuar fillimin ose përfundimin e një aktiviteti;
- ✓ Mos ndryshoni menjëherë aktivitetet dhe paralajmërojeni më parë fëmijën për ndryshimet;
- ✓ Lejojeni fëmijën të ketë afër objektin e tij të preferuar për siguri shtesë;
- ✓ Lejojeni fëmijën të punojë në një cep të qetë, ose të largohet nga salla nëse bëhet shumë zhurmë;
- ✓ Lejojini fëmijës të ketë një mënyrë emocionale të sigurt për të çliruar zemërimin ose frikën;
- ✓ Respektoni ndjenjat e fëmijës- leni fëmijën që të angazhohet me materiale dhe aktivitete në një nivel që i bën të ndihen rehat.
- ✓ Mësoni fëmijës sjelljen e përshtatshme.

SHËNIM:

Përzgjidhni vetëm rekomandimet që përshtaten me nevojat e fëmijëve tuaj; jo të gjitha rekomandimet do të jenë të përshtatshme në të gjitha situatat.

7. PËRSHTATJET PËR FËMIJËT QË KANË VËSHIRËSI NË KOMUNIKIM

Disa nga vështirësitë me të cilat përballen fëmijët që kanë vështirësi në komunikim mund të jenë:

- Belbëzimi;
- Të folurit me pëshpëritje, ose vështirësi në formulim të fjalëve;
- Paaftësia fizike për të folur;
- Vështirësi për të mbajtur në mend fjalët.

Ka shumë mënyra të ndryshme se si fëmijët mund të kenë vështirësi për të komunikuar. Disa fëmijë mund të përjetojnë vështirësi me zërin e tyre dhe nuk janë në gjendje të flasin me zë të lartë ose nuk mund të flasin fare. Fëmijët e tjerë mund të jenë në gjendje të flasin, por kanë vështirësi në shqiptimin e saktë të shkronjave ose tingujve të caktuar. Ndersa, fëmijë të tjerë mund të jenë në gjendje të shqiptojnë saktë fjalët, por të kenë vështirësi me rrjedhshmërinë dhe gjuhën, belbëzojnë, bëjnë pauza ose përpiqen të gjejnë fjalën e duhur për të shprehur mendimet e tyre.

KONSIDERATAT SPECIFIKE GJATË PËRSHTATJES SË AKTIVITETEVE HEART PËR FËMIJËT QË MBINXITEN LEHTËSISHT, MUND TË PËRFSHIJNË:

- ✓ Mbajeni fëmijën afër jush
- ✓ Mësoni rreth preferencave të komunikimit të fëmijës (gjeste, letra me fotografi, etj.)
Përfshijini ato në bisedat tuaja.
- ✓ Nëse fëmija përdor një tabelë me fotografi për të komunikuar, sigurohuni që të ketë fotografi të përshtatshme për të diskutuar artin dhe materialet e artit.
- ✓ Mos e nxitoni fëmijën dhe mos e bëni presion që të flasë.
- ✓ Mos e ndërprisni fëmijën për të thënë atë që supozoni se ai/ajo po përpiqet të thotë .
- ✓ Lejoni që fëmija të japë përgjigje me shkrim.
- ✓ Jepni mundësi fëmijës të japë përgjigje të shkurtra me po ose jo.
- ✓ Zbatoni veprimtari që kërkojnë më pak ose aspak aktivitet verbal nga fëmija.
- ✓ Zbatoni aktivitete me anë të këngëve, muzikës, imitimeve të tingullit dhe trupit.
- ✓ Zbatoni aktivitete që kërkojnë më shumë angazhim vizual.

SHËNIM:

Përzgjidhni vetëm rekomandimet që përshtaten me nevojat e fëmijëve tuaj; jo të gjitha rekomandimet do të jenë të përshtatshme në të gjitha situatat.